



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË GJASHTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 28.06.2017 (e Mërkur) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Sejdi Emini, Bislim Bislimaj, Baki Nebiu, Daut Xhemajli, Selvije Rexhepi, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostrogllava, Besjana Rexhepi, ndërsa në mbledhje mungoj, Arbresha Ibrahimimi, Nuredin Lutfiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, na ka konfirmua ligjshmërinë e disa akteve që janë miratuar nga Kuvendi. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtrij pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për të gjithë kryesues, pasi që Drejtori i Kulturës Rinis dhe Sportit s’qenka këtu, e shumë përfolura pagesa sportivin në cilin stad të procedurave është. Nënkryetar qa po ndodhë me objektin e Komunës, se është proklamua se së shpejti do të shkojmë atje të mbajmë edhe seancat, mirëpo kjo gjë nuk po ndodhë e po kryhet mandati si gjithmonë pyetje për DKA-në, në vitin 2013 ju nuk keni qenë Drejtor aty për hire të vërtetës, diku janë 13 profesor nëse nuk gaboj

kanë mbajtur mësimin jo formal kolegët po pyesin ata kurrë nuk janë kompensuar materialisht për punën që e kanë bërë, te mësimi jo formal që organizon shkolla jonë, po ashtu në vitin e kaluar kam bërë pyetje, e di që nuk është kompetencë e Komunës, pajisjet për sallën e edukatës fizike, në vitin e kaluar u patë përgjigje që janë në proces të tenderimit, e një gjë e tillë ende nuk ka ndodhë, po kryhet edhe viti i dytë zgjedhor dhe salla nuk është pajisur me objektet dhe rekuizitat sportive që është e nevojshme për mu mbajtur një orë të edukimit fizik.

Po ashtu Drejtori i Bujqësisë po mungoj ka, po është e rëndësishme të na thuhet, e di edhe në bazë të informacioneve që na i ka dhanë Plus TV, që u bë një komision për vlerësimin e dëmeve që janë shkaktuar nga breshëri, nëse ka dikush ndonjë informacion është mirë me t'aj dhanë, nënkryetar cila është shifra e damave dhe a do të kompensohet ata fermerë.

Samet Idrizi: I nderuar kryesues, të nderuar koleg asamblistë, ekzekutiv të tjerë të pranishëm, rr. “Dëshmorët e Kombit” në Viti është gërryer asfalti ka më shumë se 30 ditë dhe gropat e kanalizimit kanë mbetur hapur ka rreth dy javë ditë, ka rrezik për qytetarët se rruga është prishur shumë, sa që veturat janë ka dëmtohen, kryetari s'qenka këtu, e nënkryetar pse mbi 30 ditë është gërryer ajo rrugë dhe nuk është rri asfaltua. Në disa portale e pash një shkrim ku shkruan se në Komunën e Vitisë ka shumë mangësi, ku qytetarët ankohen, ku edhe ajo paraqet një rrezik për qytetarët, e kam potencua vazhdimisht që të ketë kujdes me shenja e gjëra tjera.

Bekim Azizi: Faleminderit kryesues, dashta një pyetje për te demet nga breshëri, Mirlinda e bani e është pyetja e njëjtë, te QKMF-ja me sa kam dëgjua janë 40 që janë qua me kontrata në vepër, në bazë t'shkafit, cila është marrëveshja që janë qua ata, atë marrëveshje me shkrim Drejtor e kërkoj, sikur që këna kërkuar dokumente edhe përpara e si ke pru asnjë, banu pak ma të ndershëm, e shkoni pak me fytyrë, se këtë fushatë që e keni bërë, keqpërdorimin ma të madh që e keni bërë, ti thirrë njerëzit që ja keni dhanë kani najlon - llastik për bahçe, ti thirrë, tu i thanë që ke marrë subvencion votoje LDK-në, prej drejtoreshave t'ju v ka qenë një diçka jo e mirë, sinqerisht po ju them nuk është bërë mirë. Marrëveshjen ma jepni me shkrim se në bazë të shkëfrit kanë shkua këta 40 dhe kush i paguan, te cili buxhet paguhen.

Baki Nebiu: Përshëndetje të gjithëve, më lejoni qytetarëve të Vitisë ti përgëzoj për zgjedhjet e fundit që u mbajtën dhe ti përgëzoj për kontributin që dhanë në këto zgjedhje, edhe pse si Komunë e vogël që jemi, po vazhdojmë edhe për dytin mandat të dërgojmë deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës profesor Sali Salihun, e përgëzoj dhe i uroj punë dhe ngritjen e çështjeve sa më të mëdha të Komunës së Vitisë, në Kuvendin e Kosovës. S' dyti më lejoni të përgëzoj një klub të Pozheranit i cili na bani krenar gjithë Komunën e Vitisë duke u futur në super ligën e Kosovës, ndihem krenar pasi që i takoj edhe profesionit të sportit, ndihem krenar në të arriturat e këtij klubi, i uroj futbollistët e trajnerët, e uroj kryesinë e në këtë rast është anëtari Ilir Zuka këtu, shpresoj që edhe klubi i Vitisë ti ndjek hapat e tij që të futet në super ligën e Kosovës, tash nënkryetar një pyetje nuk po mundem me ta bërë kur po është kryetari, që katër vjet me udhëheqjen e juaj kam bërë kërkesë banorëve të fshatit Kabash për rregullimin e parkut në qendër të fshatit dhe

çdoherë kam marr përgjigjeje pozitive nga ana e juve që do të intervenoni në rregullim, pasi që kanë kontribuar shumë banoret dhe mërgata e Kabashit që kanë investuar në atë projekt për ta prurë në këtë gjendje dhe është pritë që ta finalizoni ju dhe këtë punë nuk e keni bërë deri më tash, a do të investoni në këto muaj në atë park a po do ta leni siç e keni lënë deri më tash. Pyetje tjetër për Drejtorin e Bujqësisë e njëjta ke me Mirlindën për demet e breshrit që ndodhi në Komunën e Vitisë, a do të ketë kompensim të atyre që janë bërë, tjetra është nënkryetar a ashtu duke inspektuar dikush punimet që jeni tu i be në Komunën e Vitisë, sot isha në fushën që e keni be “Ndre Mjeda” në Kabash, ato koshat që i keni ndreq ishin rrezua krejt, me të vërtetë diçka në rregull nuk është, ose me inspektoratin që nuk pi vëzhgon këto punë si duhet ose me cilësinë e dobët të juve. Tmerr është se si ma shumë se një muaj që ish investuar në fshatin Kabash dhe të prishen ato kosha, shpreh keqardhje për investime dhe cilësinë që ju pe bani.

Bislim Bislimi: Përshëndetje gjithëve, të nderuar udhëheqje komunale, kolegë, qytetarë, nuk jam i sigurt që ka ndonjë Komunë në territorin e Kosovës që kanë eksperimente nga më të ndryshmet siç është Komuna jonë. Eksperimenti i fundit po tejkalon kufijtë e logjikës, shtruarja e shtresës së asfaltit në Komunën tonë po i ngjason gatimit të flije s, hedhet një shtresë asfalti pas pak kohe hiqet, për dallim nga flija që fryhet, ky asfalti i jonë tëhullohet. Rasti i fundit është asfalti prej “Alba Petrolit” e deri te Pasqyra, ku duke e gërryer atë pjesën po e zë 8 cm ose 10 cm e shtrojmë 5 cm, kemi ra në atë bazën kur është shtrua rruga viteve 80-ta ku është shtrua, nëse edhe njëherë e heqim këtë shtresë që është shtrua 5 cm do të dalim te ai kalldermi atje poshtë, kjo puna e jonë po shihet se në vend që të shkojmë ta rrisim kualitetin, na po shkojmë tu e shkatërrua gjithnjë e më tepër. Propozoj që qytetaret e Vitisë ta ngritin zonin e vet dhe të kërkojnë llogari për ato fonde që i japin qoftë Ministria e qoftë Komuna, dikush duhet me u përgjigj për ato pare, se populli po jep pare, kurse Ministria dhe Qeveria jonë po i hargjon ashtu qysh po ja merr mendja. A ka dikush që i mbikëqyre këto dhe ku po shkojnë parat e Kosovës.

Vehbi Rama: Përshëndetje unë mendoj se s’është gjithçka para kamerave mu realizua kërkesat e këshilltarëve komunal, po jam i detyruar me dal me kërkua, se fatkeqësisht kanalizimi në rr. “Rexhep Bislimi” mungon që katër vite të njëjtën kërkesë jam ka e bëjë, tash rasti ma i ri është rr. “Avni Rama”, te Qendra Sociale aty është një mexhe, për këtë është e njoftuar edhe Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspeksionit, të gjitha Drejtoritë janë të njoftume edhe ato qa janë kompetent dhe ato qa nuk janë kompetent, kryetari është i njoftua, aty fatkeqësisht është dal mbi sipërfaqe ujërat e zeza, kanalizimi, imagjino në Viti rr. “Rexhep Bislimi” që është ma e frekuentume edhe nuk ka kanalizim por është gropë septike, kjo është rrugë që kalojnë në atë rrugë mbi 1.000 nxënës e qytetaret edhe pleqtë që shkojnë mi vazhdua pensionet e veta, aty kundërmon erë, si të doni merrni kamerat edhe shkoni e vizitoni, aty mbi tokë është dal sipërfaqja e ujit thuaja se është pishinë.

Sejdi Emini: Unë kam disa pyetje te sektori Bujqësisë veq u kanë pyetjet ma herët, kisha kërkua që këto ndarje të bahen në mënyrë proporcionale o politike, sa i përket dëmeve nga breshëri, kam

një pyetje për Drejtorin e Arsimit, te punëtorët e Arsimit zëvendësim të lehonisë që po bëhen, punëtorët nuk po paguhen, është e padrejtë ndaj atyre punëtorëve që punojnë, e dimë që kerkund ne bote nuk ka pa pare me punua, çdo punë që bëhet edhe duhet të shpërblehet, ajo bahet edhe në sektorin privat e leje ma në institucione e ku ka ligj. Kam një pyetje për banorët e fshatit Goshicë sa i përket ujësjellësit, është një projekt që u fillua që 7-8 vite e më shumë, është kërkesë elementare e banorëve po bahet një e padrejtë ku anashkalohen projektet e filluara ma herët, tani me edhe në territor të Goshicës po bahen disa kanale e që është mire ajo që në Smire e Verban uji po lidhet me gypat, nuk e di projektin që ju e keni bërë, mirëpo banorët janë shumë të shqetësuar, për ceki pra se banorët detyrohen me shkua në Kabash, Debellde e në Lubishtë me siguru ujin e pijes. Nuk duhet me zhagite ma këtë punë, edhe banorët ma s'kanë me pas durimin, sepse uji është gjëja ma elementare për ekzistencën e njeriut.

Drejtori i Arsimit Qahil Sinani: Përshëndetje për te gjithë pyetjet janë shume me vend, mësimi jo formal vet e përmendi ilivintat e vitit 2013 me sa di unë janë 8.000 euro, ato mjete nuk i di se si kemi pas na duhet me këqyrë se ku kanë shkua dhe ku kanë mbete. Është mirë një komision nga shkolla e mesme në krye me drejtorin ato janë te 2013- tes, prej 2014-tes asnjë borgj nuk ka mbete, gjitha janë krye, sa janë marr gjitha mjetet janë shpërnda në baze te rregullores. Pajisje për sallën e edukatës fizike është shume e vërtete këtë e ka Drejtoria për Infrastrukturë prej Ministrisë së Arsimit, ngase ata e kanë rregullua objektin por obligative ka qenë edhe pajisja e sallës me infrastrukturë, fjala është dhanë që brenda këtij viti te kryhet, tash presim Qershorin, Korrikun dhe Gushtin, e sa i mbajnë fjalët nuk e di as unë, se as ata s'janë kerkund shkak i tollovisë se zgjedhjeve. Obligative është Drejtoria e Infrastrukturës me Ministrinë e Arsimit, zëvendësimi i lehonisë neve na ka gjete me një pozite shume te keqe, 6 muaj është akt, është vendim ka ardhë që vendet e lira të kërkohen nga Ministria e Financave që, me dhanë pëlqim Ministria tani me shpallë konkurs, ma e keqja është se nuk e kanë mëndu, këtu fajet i ka Ministria e Arsimit, se nëse sëmuret një punëtor sun e zëvendëson, se sun e pagunë, konkurrenca është shumë e madhe e ka dashmirë që vijnë me mbajt mësim vullnetar edhe pa pagesë. Për me kërkua një vend që sëmuret dikush ne Ministri nuk mundem me ditë sa rri në pushim mjekësor ai, a rri një muaj a po dy muaj, a 15 dite vonohet Ministria e Financave deri ta jepe pëlqimin, tana konkursi 15 dite e kalon një muaj, e ner 15 dite nuk ki të drejtë me shpallë, mundet me ndodhë tamam e shpallë ti ai kthehet në vendin e punës e krejt shkon kotë, e për pushime te lehonisë po, e është një rast ne Goshicë që del ne fund Qershorit e Korriku e Gushti eshte pushimi, e konkurset shpallen me 10 Gusht për gjitha vendet e lira që janë ne Arsim, për rate arsye nuk u shpalle, pushimi i lehonisë pranohet se janë dokumentet, është pushimi 6 muaj apo 9, ma e keqja është kjo se 5 muaj apo 6 ka ardhë ne fuqi edhe neve na ka qite me një situatë shume te keqe.

Drejtori i Inspeksionit Skender Ahmeti: Faleminderit kryesues, përshëndetje nënkryetar, bordi i drejtorëve, dashta te përgjigjem në pyetjen e Sametit sa i përket atyre që po qesin nëpër portale, sepse portalet po qesin pak tituj bombastik, që ta shikon dikush me ndonjë klikim, përndryshe

gjendja ne sinjali stikën vertikale dhe horizontale ne Komunën e Vitisë është aq e keqe, dëmtimet vazhdojnë ne shume faktor, ne shume shpejt do te operojmë ne rregullimin e krejt sinalistikes në territorin e Vitisë, besoj qe brenda javës do te zgjidhet ky problem e nuk do te diskutohet për këtë qeshtje, sepse do te vendosen shume shenja te komunikacionit edhe shumë rreshtime të automjeteve, vendkalime te këmbësoreve, e sidomos afër shkollave, e kemi paramendua qe të vendosim edhe mjete reflektuese ndriçuese për qytetaret. Ndërsa sa i përket pyetjes se Bakiut të inspektimit te fushës se sportit ne Kabash apo diku tjetër, projektet e Komunës nuk i mbikëqyrë inspeksioni, janë kompanitë që i mbikëqyrin, e veq dashta mu shkarkua nga përgjegjësia.

Drejtori i Financave Ibrahim Rama: Përshëndetje për të gjithë, i parashtruat disa pyetje qe kane te bëjnë me aspektin e zhvillimit te infrastrukturës, tu fillua prej palestrës sportive e deri te ujësjellësi ne Goshicë. Sa i përket palestrës është një projekt i financuar nga Ministria përkatëse e Kulturës, procedurat e tenderimit dhe përzgjedhjes se operatorit për realizimin e këtij projekti qe i është dhëne Komunës së Vitisë, e këna përgatitë është në fazën e fundit te tenderimit, ku kanë përfundua ofertimi i operatoreve ekonomik, shume shpejt do te fillon edhe shpallja e fituesit te këtij projekti, e që është projekt tre vjeçar mbi 1 milion e 400.000 euro dhe në vitin 2017 janë të dedikuara mjetet financiare qe duhet mu realizua ne palestrën sportive vlera prej 300.000 euro. Asfaltimi i rr. “Dëshmoret e Kombit” është projekt i financuar nga Komuna e Vitisë dhe Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal vlera e projektit është diku 153.000 euro, 100.000 euro i financon Ministria gjegjëse dhe 53.000 euro i financon Komuna e Vitisë me buxhet t137 saj, projekti është ne realizim e sipër, me plan dinamik e ka afatin dinamik të kryerjes se punëve, është proces, nuk i ka kalua afatet, n137 ekzekutim është, e ka naj pengesë te vogël ne aspektin dinamik, po menaxheri i projektit e ka planin, e mbikëqyrë çdo ditë. Kam dëgjua qe kane bërë vërejtje ne aspektin e sinjalizimit të rrugëve, sinjalizimi i rrugëve regjionale behet me buxhet te Ministrisë se Infrastrukturës, ne aty nuk kemi qasje si Komunë, ndërsa te gjitha rrugët lokale i kena realizua shenjzimet dhe i kemi projektet, e kemi që financonet nga Komuna e Vitisë, për shpenzimet ne aspektin e she njëzimit te rrugëve. Kontrata te disa punëtoreve ne QKMF Bekim Azizi qe beri një pyetje për këta 40 punëtor qe punojnë ne shërbimin e mirqenjeve sociale, është marrëveshje e nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe Karitas Kosova, qe është bashkëfinancim, i kemi tri kontrata, njëra bash financonet nga Komuna, Karitas Kosova dhe Ministria e Shëndetësisë dhe kontrata tjetër financonet nga Komuna, Ministria e Pushtetit Lokal, d.m.th., Pushteti i Mirëqenies Sociale dhe Karitas Kosova dhe një kontratë tjetër bashkë financonet nga Komuna dhe Karitas Kosova, janë tri marrëveshje, e bashkëfinancim i Komunës është për këto nevoja. Përzgjedhja e këtyre punëtoreve e bene Karitas Kosova qe e ka selinë ne Ferizaj, përzgjedhja nuk është ne duart e Komunës se Vitisë, ajo behet me thirrje publike, e ata qe i plotësojnë kushtet sipas Karitas Kosovës edhe punësohen me afat te caktuar sipas kontratës qe është nënshkrua. Parku ne qendër te fshatit Kabash, edhe një kërkesë e qytetarëve te Kabashit, e kemi në projektion, shume ka deficite ne kuptimin e infrastrukturës gjelbëruese ambient ale, por buxheti nuk na mjafton mi krye këto menjëherë, por besoj qe shume shpejt do te përfundoj kjo kërkesë e qytetareve. Dy halla i kemi kur inspektohen projektet e Komunës, është mbikëqyrja qe shërben mi dhanë me kontratë,

është operatori ekonomik qe çdo dite del ne terren dhe i viziton ato projekte dhe menaxheri i projekteve qe është drejtpërdrejtë prej zyrës Kryetarit të Komunës, inspektohen te gjitha projektet qe janë ne interes te qytetarëve. Lidhur me pyetjen për fushën sportive në Kabash, këna marr informacione qe ka disa probleme aty, e sot e kemi njoftua operatorin ekonomi, pranimi teknik nuk është be, ka premtime mi përmirësua brenda ditës. Problemet e rrugës prej Pasqyrës, ku Bislimi e bëri një pyetje qe asfalti nuk është i nivelit të mirë, para pak ditës u shtrua kjo rrugë, për shkak te defekteve që kanë ndodhë të kanalizimit të ujërave atmosferike, e ka dëmtua rrugën, ajo rruge është regjionale nen kompetencat e Ministrisë së Infrastrukturës, e tash ajo rruge është bere edhe shenjzimi e është ne rregull kjo pjesë e rrugës ku ka qenë me defekte. Kanalizimi një problem te Qendra Sociale, unë e drejtori i Shëndetësisë jemi ne vend te ngjarjes, e dimë këtë problem, kena dhanë urdhër me projektin e vitit 2017 me rregullua këtë problem te ujërat e zeza. E sa i përket ujësjellësit të Goshicës është një projekt i trashëgim nga viti 2012-2013, nuk është krye marrëveshja, nuk është finalizua ndërmjet qytetarëve të fshatit Goshicë e Komunës dhe CDI-së, marrëveshjen e kam dhe është publike, ka pas me participu fshati Goshicë me 70.000 euro, një pjesë ka pas Komuna e Vitisë, edhe 140.000 KQZI-a, ka qenë projekt i përbashkët me Drobesh, Goshicë dhe në Gërmovë, Gërmova e Drobeshi e kanë pagua participimin, e Goshica ka mbete 70.000 euro, e kena lidhe një marrëveshje tjetër se problemi është i përbashkët, e kena mendu një pjesë te buxhetit te vitit 2017 ta drejtojmë mundësisht përmes Kuvendit Komunal. Edhe kësaj radhe do tju drejtomi juve për një pjesë te Buxhetit për me financua obligimet e qytetarëve të Goshices, e problemi i ujësjellësit të Goshices të zgjidhet së bashku me Germovë edhe pse pjesa dërmuese është e përfundume.

Samet Idrizi: Rr. “Dëshmoret e Kombit” qe 40 ditë është e gërryem, qytetarët po thonë para Shtatorit nuk kryhet, unë thash duhet mu shtrua, ajo është katastrofë, dil këqyrë vet, tmerr është, kqyrne e merrni masa, su kane dashtë me gërrye 40 ditë me nejt ashtu.

Mirlinda Sadiku: Pyetje për Drejtorin e Arsimit a mundesh me na premtua që deri në fund të mandatit do ti kryesh ato obligime financiare, kush do ta këtë fatin me qeverisë Komunën ka me lanë borgje, e ky obligim financiar duhet te kryhet ndaj tyre. Sa i përket palestrës sportive sipas asaj qa u publiku ne Ministrinë e Financave 900.000 euro janë te ndamë për këtë vit, është projekt tre vjeçar, ndërsa dy vitet tjera ka 200.000 euro, kjo është ajo qa është zyrtare e publike e na duhet me besua drejtor.

Sejdi Emini: Te drejtori i Arsimit po ndalem që tha qe ka shume qe punojnë ne mënyre vullnetare, nuk i kisha quajt vullnetar, po i kisha quajt nevojtar, se ata e kane prej nevojës për me zane një vend pune, e n ashta punon 6 muaj a 1 vjet me shprese qe ma me marr atë vend pune, e ne fund nashta se merr hiq, e mos mendo qe vje dikush me punua prej qejfit pa pagesë harroje, kjo o shume normale se nevojë e njerëzve. Te ujësjellësi i Goshicës kemi fol na edhe me CDI-në Zvicerane, borgj i ka Komuna e jo qytetaret, qytetaret kanë dhanë pare e janë te obligume me ja kthye ata, se

qytetari nuk ka qe participin ma ne kanalizim, ujësjellës e në shkollë, mos i banë borgjli qytetarët se borgj Komuna i ka, kryeni obligimet e juve e ne të vje uji, mos te zhagitet ma shumë.

Nënkryetari Hasan Aliu: Unë e kuptoj fazën te cilën jemi, i kuptoj mocionet te cilët i kemi, ambiciet është shume normale, rone gjithë herë se edhe unë merrem moti me politike, kam kalua faza te ndryshme, por ju kam ruajt vetvetes e do ti rryhem gjithë, se pamarre parasysht kush do te qeverisë edhe pas zgjedhjeve do te jetojmë ne Viti pavarësisht kush ne pozite e kush opozitë. Te palestra Mirlindë qështja 900.000, 1 milion e 400.000 është qeshtje qe ti i parasheh 900.000 po ofertuesit ku te hynë, kane hi me atë çmim dhe janë në fazën përfundimtare, buxhetin qashtu e kane aprovu, po tash ata po hijnë njëherë se po thonë sun e qesin. Çështjen e borgjeve te vitit 2013 shume e debatuat, e jam i bindur qe po edhe ne do te lajm borgj kur ta përfundojmë mandatin, veq 1 milion e tepër me naj marr gjykata ato te jeni te sigurt, edhe pagesa e qaty ne nuk është e lehtë sun e paguan drejtorit kote i thua, ata duhet me ndjek procedurën gjyqësore, kane kalua krejt ata afate ne rast se e kane bazën juridike, e unë po besoj qe e kane e i fitojnë paret ne aspektin gjyqësor, a është be mire qe si kanë pagua jo. Komisioni për vlerësim te dumeve qe ka ndodhe si pasoj e breshrit kem formua komisionin edhe për vlerësim te dëmeve ne ekonomi e ne bujqësi, e sot me raportua se e kanë përfundua, përveç dëmeve në bujqësi ka pas dame edhe ne dy shtëpi, dame edhe ne ekonomi, e kanë evidentua e sa është vlere nuk i pyeta, e krejt ato raporte te kompensimit na i qojmë ne Ministri te Bujqësisë, nëse ka fonde Ministria i kompenson, ne rast se jo, s’jemi garantues, e garantues duhet mu kanë nëse qe ky kuvend i ka parapa mjetet dhe i ki ne buxhet, atëherë na garantojmë nuk është problem, veq puna është krye me piedestalin ma të lartë t ‘mundshme. Qeshtjen e e rrugës Samet do te kujdesem e kam pa rrugën “Dëshmoret e Kombit”, por tash këto planet dinamike boll naj kane hup edhe neve me këqyr sa e ka kohen, ne rast se i ka tejkalu do te jem ne mesin e tyre qe do te insistoj që sa më parë me krye, po ne rast se ka ti kote e thirre thotë unë e kam afatshmerinë, kontratën, e kaloj edhe unë atypari e bash tmerr nuk është po ka nevojë mu rregullua mu asfaltua. Te shenjat e komunikacionit u përgjigjen dy drejtorë, ai i ekonomisë dhe ai i inspeksionit qe e ka për obligim. Te qeshtja e QKMF-së e tha drejtori, e Bekimi po me vje keq qe s’qenka këtu, nuk e di me qfare kuptimi e thotë ai ndershmëri, qe po thotë se paku këta tre muajt e fundit te jeni te ndershem, e une ,mendoj qe jo tre muaj po jena kane katër vjet, do te vazhdojmë me qene edhe mbas katër viteve, pavarësisht relacionit ku do te jem e nuk naj cakton Bekimi se a do te jem ne opozite a pozite, por e caktojnë qytetaret e Komunës se Vitisë, pavarësisht rezultatit për neve do të jetë i pranueshem, por ndershmëria do te jete deri ne vdekje. Këtë urimin për ekipin “Vllaznia” na e kena urua kur ka dal, se s’jemi kane në France po këtu jemi kane, e kem këqyrë lojën, e ti koke vonua në ketë drejtim pak. Rregullimi i parkut te fshatit, e di qe e kem pas një kontrate dy vjeçare edhe e kena përfundua, serish na dotë punojnë ne hapësirat e gjelberta e do ti vjen radha edhe Kabashit, e ne Kabash ka investime shumë se Buxheti ndahet edhe ne koke te banorit, e është mirë me na u falënderua për këto investime, po na kemi nevojë edhe për këtë e është mire ne te ardhmen me parapa. Koshi po me vje keq qe ka ra, a e keni prish natën a qe ka ndodhe unë nuk e di, jam për me shtua inspektimet, jam për një pune sa ma kualitet, jam për një kontrolle dileme nuk ka sa ma e mire te jete e mundshme. Inspektohen, përveq

kompanisë që është e pagune, e kemi edhe mbikëqyrjen nga ana e Komunës, do të merremi edhe me atë qështje, në atë afatin që e ka në garacionin e punëve e do ta rregullon e nuk do të ketë problem, e nuk dihet pse kanë ra a është fajtor një pune e dobët a po është, a po faktori njeri. Besim te qështje e rrugëve magjistrale, e kam thane edhe ne televizion se në këtë mandat Vitia është pa ma së miri, e është mirë me pa me një sy pak ma real me be krahasime se ku ishte Vitia ma herët e ku është tash, e boll nuk them se nevojat janë shumë të mëdha ja, e sigurisht ka nevojë për investime, e shpresoj që hapin që po shkojmë do te realizohen. E atë shqetësim që e ngrite nuk është veq Kuvendi, momentin qe e ke pa ke muajt me ju drejtua, për atë janë edhe dikasteret, janë Drejtoritë, Drejtoria e Shërbimeve Publike qe ka qenë obligative te intervenon edhe te Ekohigjiena, se kuvendet mbahen një herë në muaj, e mirë që e ke shtrua këtë pyetje po ne e kemi edhe kryetarin e këshillit te fshatrave kanë muajt mu rregullua, po do ta shi qojmë. Sejdi edhe për ty vlen e njëjta, nuk pajtohem, por nuk e diskutoj qe s'është nevojë, e në këtë mandat në Goshicë kem be shumë, e sivjet edhe rruga ka mu asfaltua, duhesh me qenë shumë parimor. E sa i përket marrëveshjes që the tash qytetaret nuk participojnë, e marrëveshja është e viteve të kalum e nuk është realizua për shkak të participimit te juaj që unë nuk e di. Ne jemi përgjegjës për buxhetin e Kuvendit Komunal të cilët e aprovon ju. Për kërkesat që sot i keni parashtrua neve na vyen nja 6 vite mi pas me muajt qeto kërkesa për një vjet mi realizua.

Baki Nebiu: Është e vërtetë që kam qenë në Francë, e shpenzimet i kam ba personalisht, nuk e kam obligim me ju vet juve se ku shkoj, nuk jam si ju që merrni shoke e shëtitni Evropën e kurrë një investim se bini ne Kosovë. Tjetra “Vilaznia” ka luajt me 3 Qershor dhe asnjëherë Kuvendi nuk është mbledhë prej se u zhvillu loja. Unë jam i lumtur për suksesin e tyre, e nuk e kundërshtova qe ju keni be një urim, se është bere një punë e madhe për krejt qytetarët e Vitisë. Tjetra për Salihun unë e di qe juve ju dhemb po ky rezultati i qytetareve të Komunës së Vitisë. Tjetra për cilësinë ne Kabash qe e keni be është mirë me shkua me këshyre edhe masi të kryhet mbledhja, është turp, e nuk thamë qe nuk keni investua në Kabash e për nga cilësia jeni shumë larg PDK-së para juve.

Vehbi Nebiu: Ne rend te pare Vitia nuk është kërkesë e fshatit po është qytet. E për kanalizim fatkeqësisht thash edhe ne fillim, nuk është gjithçka përmes mediave para kamerave, qe 6 muaj është kjo kërkesë pyete kryetarin, drejtoret, jo përmes mediave po përmes Zyrës Sociale edhe përmes Shërbimeve Publike, e drejtori tha do të rregullohet në 2017- ten, kjo është rast urgjent, dilni në terren, duhet për 17 ore të intervenohet me cisterna, se tash kundërmon.

Sejdi Emini: Te gjithë këshilltarët komunal pamarrparasysh cilit subjekt jam, jam për me mbrojt interesin e qytetarëve edhe po te isha ne pozite do të isha në anën e qytetarit. Nënkryetar kam ngrite qështje e sa i përket Remnikut as atje nuk është gjendja ma e mire me ujë të pijes qe o sendi elementar, kam informata që nuk është ma mirë. Në Goshicë as nxehmje në shkollë po nuk po kërkojmë, por pe kërkojnë ujin qe o sendi elemtarë.

Nënkryetari Hasan Aliu: Nuk dua me replikë po me të tregu Baki s'me ke mungua hiq, bash asnjë sekondë, unë si nënkryetar Komuna e di qe dy here kam dal jash vendit jo me shokë vet zyrtarisht, deri sot Vitia nuk ka shënua dy xhipet me nejt para Komune e na udhëtojmë me kerre tona, tu nis prej kësaj kurrë ski pas ma të përgjegjshëm se kryetari, as ski me pas. Mua me ka gëzua me pas muajt jo vetëm deputetin Sali Salihun por me pas muajt të gjithë ata që kanë garua në Komunën e Vitisë nga te gjithë subjektet i kisha qu. E sa i përket "Vllaznimit" krejt ve na ka gëzua se adita na jena kanë në stadium i kena urua e kena prit, tash nuk shkon urimi e nëse ke naj mundësi ndihmoju se kanë nevojë për ndihmes materiale, nëse ke naj ide që ky Kuvend mi ndihmua qite e ke Hasan Aliun mbrapa. E sa i përket thënieve tuaja unë nuk kam thanë qe s'kemi nevojë për ujë, nuk kam thënë që Remniku e ka ujin, se ka, jam parimor a e di cili është parimi në rast se i kem 2 milion Sejd hajde i ndajmë në mënyre të drejt e tana e këqyrim se a pi b'je Goshicës me rregullu ujin a kujna pi bje. Ju jeni aprovues te buxhetit ju pe harroni profesionin e juaj, krejt me vjedhë, Komuna spo mujke me vjedh, duhet mi pas paret e sigurime për mi realizua këto projekte, tash do ti hymë fazës së përgatitjes së buxhetit do ta keni edhe tash diku për 700 e diçka mi euro që Komunës së Vitisë ju ka rritë buxheti, nuk është një shumë e madhe, por ka hapa përmirësimi në këtë drejtim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit, Nënkryetar, të gjithë juve Këshilltarëve Komunal për adresimin e pyetjeve, disa shumë konstruktive e disa jo, e në mbledhjen e gjashtë të Kuvendit Komunal kemi parapa këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e KK-së të Vitisë.**
- 2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2018-2020.**
- 3. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme të Komunës Kompanisë KKDFE sha KEDS J.S.C për vendosjen e trafove elektrike.**
- 4. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm parcelat kadastrale me nr. 378-10 nr.378-12, nr.357-10, nr 58-101, nr.58-103, nr. 334-2 në zonën kadastrale në Radivojc të cilat prona janë të menagjuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.**
- 5. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm të parcelës kadastrale me nr. 448-100 në zonën kadastrale në Drobesh**
- 6. Raport i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së), për periudhën Janar-Qershor 2017.**

A ka dikush rreth rendit të ditës? Kush është që të miratohet ky rendi i ditës me këto pika? Nga të gjithë të pranishmit u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rreth procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin, me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë

2. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), 2018-2020.

Drejtori z.Ibrahim Rama: U parashtruan një numër i pyetjeve , unë në fillim thash se buxheti është ligj që i inkorporon politikat makro ekonomike unë edhe shumë herë mundona mi analiza politikat e nivelit qendror por mundësia me i ndryshua është zero, ishte një pyetje projeksionet a duhet me u përputhë , projeksionet nuk është e thanë me u përputhë ato janë ide , buxheti i vitit 2018 duhet me qenë i saktë , ishte një tjetër pyetje te subvencionet kam kërkuar nga ministrin që subvencionet të ju barten komunave sepse ne e dimi ma së miri dhe dimi mi menagjua ato mjete , të hyrat vetanake edhe unë kam qenë me qenë ma të mëdha nga ko që kemi kam dëshirë që të jenë ndoshta edhe 2 milion euro por kjo nuk shkon kështu , unë u mundova që në pika të shkurtra të cili pak pikat të cilat i diskutuam **Kryesuesi z.Naim Pira:** faleminderit drejtor e hedh në votim të që shkojë në kuvend këtë pikë të rendit të ditës , me vota unanime shkon në kuvend , si pik tjetër kemi

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës.

Znj. Vjollca Kadolli – Halili: Të nderuar Kryesues i Kuvendit, këshilltar, media, drejtorë, para vetes e kemi kornizën afatmesme buxhetore ose qarkoren e parë buxhetore ashtu siç quhet ne ekonomi për vitet 2018-2020, është një dokument i cili e përcakton rrjedhën edhe te investimeve në vitin pasus. Analiza qe e bëri drejtori është shumë inkurajuese se Qeveria e Kosovës ka bërë rritjen e buxhetit për Komunën tonë për rreth 800.000 euro edhe pse nuk është shumë e mjaftueshme, se duke njohur problematikat kemi më shume nevojë, por megjithatë do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e jetës së qytetareve, vlen të falënderohet edhe Kryetari Haliti me Qeverinë Komunale, konkretisht Drejtorinë e Financave. Në vitin e kaluar kemi pas edhe shkurtime buxhetore, megjithatë kryetari me ekipin e tij, me donacione, projekte të ndryshme kanë arritur që në masë të madhe të bëjnë investime në infrastrukturë, e ka ndryshuar pamjen qytetit edhe fshatrave për rreth duke i dhanë nuance tjetër Komunës së Vitisë. E përmendi drejtori edhe shëndetësinë qe është ndarë një buxhet qe është rrite buxheti edhe për 116.000 euro, ajo qa me ka pëlqye është se në vitet 2012-2013 diku përqindja e investimeve kapitale në shëndetësi ka qenë 1 pike 8 e 1 pike 9, ndërsa tani ka kalua përqindjen 7% që është shumë pozitive, shpresoj që edhe ne vitin 2018 te vazhdojmë me intensitet të njëjtë edhe Qeveria Komuna duke përmbyllë edhe kapitullin e investime në infrastrukturë rrugore, ne ambient, ujësjellës, kanalizim.

Samet Idrizi: Propozim vendim për shqyrtim të kornizave buxhetore 2018-2020, drejtori i financave tha se kemi një rritje diku 7% ne krahasim me buxhetin 2017. Sa ka qenë buxheti i vitit 2014 i projektuam, me sa e di unë është një buxhet përafërsisht i njëjtte vetëm 5 vjet ma vonë. Investimet kapitale në vitin 2014 kanë qenë të njëjta, mos ndoshta ma shumë se 1 milion e 200.000

edhe buxheti ka qenë i njëjte, jemi 5 vjet ma vonë ka qenë dashtë minimumi në buxhet diku 11 milion euro. Struktura e buxhetit e ndamë nuk më pëlqen, pagat e shtesat këtu nuk muaj n me ndikua, nevojat për investime janë ende të larta, ka rrugë shumë që duhet mu shtrua, ka rrugë që kanë nevojë për kanalizim, ka rrugë që nuk kanë ujësjellës, unë e kam vërejt që çdo dy tre vjet blihen karrige, kompjuterë, mobile nuk ka nevojë ato duhet me u ruajt. Propozimi im është nëse ka mundësi me intervenua sidomos te pozicionit të madhrrat e shërbimit, në raport me investimet kapitale do të ishte shumë mirë për një qytetar në Komunën e Vitisë, përndryshe grupi i PDK-së do të abstenon me këtë pikë.

Znj. Mirlinda Sadiku: E kuptoj që është vetëm projeksion, deri në Shtator do të pësoj ndryshime. Drejtor te faqja 20 në fillim të Kornizës, atje i referona faqes 7, ju keni thanë se numri i punëtorëve të Arsimit është 796 sipas regjistrit të fundit në Maj. Planifikimi kur u bë për vitin 2018 është 815 nuk korrespondon me këtë që është cekë në fillim të kësaj kornize, ndryshon faqe 7 është 769, ndërsa faqe 20 815 punëtor në Arsim. Është një lajm i mirë për të gjithë qytetaret e Vitisë, rritja e grandeve qeveritare diçka që i ka mungua Vitisë me vite të tëra 7.17, po ashtu nga gëzon fakti për rritjen e grandin sidomos të Arsimit, kur e dimë që keni shumë kabinete, shumë shkolla që kanë nevojë të intervenohet, po ashtu të pajisen me kabinete qoftë nga biologjia, kimia. Krejt që mund të flasim në këtë kornizë është diku 30% të kësaj shume totale të buxhetit, aty mund ti japim vërejtjet nëse merren parasysh. Po ashtu me gëzon fakti për një investim kapital prej 21%, pati kërkesa në fillim të seancës se ka probleme me kanalizim, shumë ujësjellës nuk janë funksional neper katunde te Vitisë. Sapo na tha nënkryetari se nuk ka mundësi të kompensohen demet që janë shkaktua nga breshëri, fermerët e Vitisë sivjet kanë pas vështirësi nga breshëri, rrufeja e nga zjarri, ju shkaktohen dame të mëdha ja, a do te kishte mundësi te parashihet një fond ne këtë buxhet, i cili do të kompensonte këta, e mos te mbeten vetëm ne mëshirën e nivelit qendror. Mendimi është që subvencionet në Bujqësi janë shifër shumë e vogël 33.000 euro. Ky kuvend ka miratua shumë strategji, si strategjia për mbrojtjen nga zjarri, strategji për personat me aftësi të kufizuara që ka pas kërkesa për këta persona që të këtë një zyre, të këtë një buxhet të caktum. Po ashtu ky kuvend e ka miratua edhe një planë të mobili tetit, ku të gjitha këto e kanë koston e tyre financiare, nuk kam pa që janë parapa këtu. Jeni nderë Komunat e para qe keni be ma së shumti dëgjime buxhetore, mirëpo sa po merren parasysh këto dëgjime buxhetore, me kujtohet në vitin 2014 ose 2015 Dr. Xhyle me grupin e grave të Vitisë kemi qenë të gjitha njëzëri qe te përkrahen gratë lehona të cilat janë ne skenën sociale me 100 euro, është shumë simbolike, e po shihet edhe nga numri i nxënëseve qe ka ramje, do të reflektoj edhe në grandin e përgjithshëm të Arsimit që do të jepet, sepse ndarja bahet për kokë të nxënësit, kjo është parapa, nuk merret parasysh. Po ashtu me grupin e grave kemi ngrit zonin që të përkrahen financiarisht për pagesën e mësimit jo formal tri femra dhe dy meshkuj ata te cilët janë në raste sociale, kurrë s’u marr parasysh. Te investimet kapitale unë potencoj se s ‘fundi Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal nëse nuk gaboj ka investua tek gjimnazi, ka planifikua te bëjë ndërrimin e kulmit, është mirë të investohet edhe brenda se klasat e vicet janë në gjendje t’ mjerushme, e kam dokumentua me foto. E tha Bakiu lajmit të mirë i gëzohemi gjithë për klubin “Vllaznia”, e këtu nuk u be një trajtim ma i veçantë, ma special. Klubi futbollist ik “Uniteti” ne vitet e 90-ta kur ka qenë sfidues mu marr me futboll, ata kanë qenë edhe në super ligën e Kosovës e kane përfaqësua denjësisht Vitinë. Po ashtu ma merr mendja që duhet te rritet fondi për bursa, se fundi kur e patëm thirrjen nga Drejtoria e Arsimit e pamë se patë një numër te madh te studenteve, me të vërtetë një shume simbolike nga 50.000 euro, po ashtu e kemi parasysh se gjendja ekonomike dhe sociale nuk është e mirë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Klubi “Vllaznia” është vërtetë një klub që ka arrit ligen e parë ti falënderua edhe donacionet nga Komuna, nëse dojmë na praktikisht me dhanë kontributin tonë hajde ta bëjmë një propozim si Këshilltar Komunal kani mëditje nëse na lejon ligji.

Bekim Azizi: Edhe tre muaj pi mbanë zgjedhjet Kryesues, po Kuvendi edhe mbas tre muajve funksionon, pak punë është a jemi na a s’jemi, se çdo zgjedhje janë te mira se bajn ndryshime pak edhe do plaken e do hecin e vine do të ri, politika naj ka pru qeto e s’bënë mi marr për t ‘madhe, mirëpo mos i lidhni krejt senet me politikë, ma e keqja është kur e shfrytëzon vullnetin e qytetarit, paren e qytetarit e këta zakonisht e ka mundësinë ekzekutivi. Në politikë e shfrytëzojnë drejtorët, kryetari ata që e kanë pushtetin, e shfrytëzojnë edhe paret e qytetarit për politike, e në këtë mandat e keni shfrytëzua ju. Vjollca tha qe ke be ndryshime në Viti, cilin ndryshim e sheh në Viti, hajde këqyrni këto bimë që janë të mbjellte a e keni mbjell najnja ju, trotuarin a e keni be ju, sheshin a është i njëjti që u kanë, Komuna është e njëjta edhe e lyrja jashtë është ne kohen kur u kanë PDK-ja, objektet që janë ngjyros krejt janë në kohen e PDK-së, qa keni be ju, qa ke ndryshua në Viti, këqyrni fotografitë e Vitisë, e keni shtrua ni bioasfalt 7 santi ka thanë Drejtori e 2.50 është, 4.50 senti e keni vjedhë, pare me buxhet janë këto, janë do rrugë që janë shtrua, po jo kualitative, ky buxhet ka mu miratua ne Shtator për vitin e ardhshëm edhe projektion për dy vitet e tjera. Planifikimi i buxhetit bahet keq se nuk definohen ndarjet. Ktu vjen e thotë se në muajin Maj 2017 mësimdhënës mbi 796, duhet me dite sa punëtori i ke në rrogë, janë 796 e mbi 796 munden me u kanë 1000 numri i shifrave s’ndalet, shifrat e atyre që marrin rroga qiti të sakta. Ne QKMF ka të punësuar rreth 139, duhet saktë numrin e punëtoreve e mos bani hajgare, e dimë se qa jeni tu be, tu luajt me njerëz, na e dimë që i keni qua do me rroga po me 01.Janar hecin krejt ne shpi edhe ata qa kanë shkua e dine. Ka shume projektione qe si kemi parapa, shembull të hyrat nga mësimi jo formal i parasheh vitin e ardhshëm 2.000 euro, cilat drejtime i ke planifikua që me ardhë aty, se 150 euro kushton një regjistrim, ne baze te kësaj i ke planifikua 13 nxënës pak ma pak se gjysmë, shko bile t ‘plotë, qysh ta planifikosh regjistroj e atëherë buxheti është i saktë e jo vetëm me shkrua shifra. Qfare shëndeti kena me pas në vitin e ardhshëm kur planifikohen të hyrat vetanke 400 euro, të hyrat nga Inspeksioni i Shëndetit dhe i Sigurimit 400 euro për një vjet, hiq bre mos ndreqni se 400 euro na i mbledhin e i japim edhe ne ta kryen punën % e realizon për buxhetin, e mos bani hajgare. Na e dimë që parkimi janë njerëzit që e shfrytëzojnë me qira, paguan tatim ku është këtu, hiq nuk është ngarkesa e dëmit qe ka mu pagua në vitin e ardhshëm, kur ta parashihni ne projektion te hyrave, e atëherë qitni këtu se ketë pjese e ka, e atëherë e parashihni se ai e ka marr tenderin saktë na e dimë sa ka me dhanë, plotësoni të hyrat, këto informata qa janë të parapamë. Funksionimi i shitorëve parashihet 25000 euro përskej të rrugëve me hi, funksionimi i shërbimeve tjera hi, i bankave hiq, ata qa shesin rreth asfaltit duhet me dhanë. Të hyrat vetanake duhet të parashihen mirë, buxheti është kryesorja e funksionimit te ekzekutivit të Qeverisë Lokale, parashihni pikat ma kritike që e përmirësojnë kualitetin e qytetarëve, e punimeve, tmerr është qa keni be. Duhet ma serioz me dal na para zgjedhjeve, jemi të interesua që në Shtator kur del buxheti, me dal një program i mirë, një buxhet i mirë, i realizueshëm dhe i orientuar drejt.

Znj. Vjollca Kadolli-Halili: Bekimi ma bani pyetjen qa ke pa në Viti që ka ndryshua, në lagjen ku ti e ke një punëtori dhe shkollën teknike ku punon, po llogaritet që je shumë i izolua e nuk del në Viti jashtë asaj rruge, lëshoja një sy asaj rruge që di me ta përshkrua çdo centimetër qa është investua qe ty ta ka ndryshu jetën edhe punën ku ti punon, është keq me thanë që në Viti nuk kem be kurgja, unë po të pyes veq për lagjen tanë, tu fillua me trotuar, rrugë, ndriçim, se unë qe dy vite e kam lëshu atë banesë, veq atë rruge përshkruama para dy vite e qysh e sheh sot.

Bekim Azizi: Rr. “UQK-së prej rrethit, është kontraktua një asfalt 7 centimetra, u shtrua 2.50, asfalti u kanë shumë i mirë tash është ma i keq, e dyta dy objekte ka 6-7 kate pa leje nuk ka vend as me parku mjetin, e keni shkatërrua Vitinë me ndërtime pa leje, këta e keni be ju edhe te Posta edhe objektet tjera edhe marrëveshjet. Ne morave ski investua sene, qeto bimë qa i ke ne Moravë i ke pas t’mbjellta qeto krejt janë kanë aty, qai muri është kanë i ndreqtë, ski investua qaty, po teposhtë. Shkolla Teknike kur ke ardhë ti veq u vnu qelës se ajo është financim i Qeverisë, krejt i ka Ministria ato, asnjë cent t’jauj ski pas hiq, e fati ka ardhë që shiriti u pre kur jeni kanë ju, skeni investua ju hajde këqyrni kabinetet, punëtorinë, këqyrni makinat që i keni prish ti bajt, dëme keni be, këqyri ndryshimet krejt janë me fotografi.

Sami Demelezi: Përshëndetje për të gjithë, unë nuk e di kush e ka kallë Shtëpinë e Kulturës, Bekimi po e dika, e keq si asamblist pse ski lajmërua organet qe u dashtë të lajmërohen, ti e di shumë mirë që ka ndryshua gjendja për t ‘mirë, qeto drunjte i keni mbjelle na u dashtë mi shkul e mi mbjelle tjerë, po jo Bekim na e kem vazhdua qashtu janë t ‘mirë. Ti e dine qfare parku ke pas kurrë nuk keni dal me mirëmbajt, tmerr u kanë parku në Viti e sot është shumë ma mirë e dinë edhe qytetarët. Shtrati i lumit Morava tmerr u kanë prej llastikave e mbeturinave, e sot mirëmbahet shumë mirë. Një urë e keni fillua, e keni lanë në gjysmë. Shkolla po thua na e kem fillua, Qeveria e ka financua, e shkollën e Sllatinës ju e keni fillua e keni lanë tmerrin ma te keq, kanalizimin këtu në Smirë dhe shumë tjera që i keni lanë defektet, qe sa vjet jena tu marr me defektet që i keni lanë ju, veq dashta mi kallxua Bekimit për ndryshimet qe i kem be. Unë kontributin temë sa i përket kabit e kam dhanë e qëndroj prapa atyre që kam thanë, e me vjen mirë se e keni një buxhet ma të mirë se sa vitin që e lamë pas edhe pse vitin e kaluar kemi pas fillua me skepticizëm e kemi prokullu mirë, konsideroj se do të jetë edhe shumë ma mirë.

Bekim Azizi: Është e vërtetë që kam dyshua te Samiu, se je edhe këshilltar i kryetarit edhe i shëndetësisë, për ty ka ndryshua edhe parku se i ke shti 200.000 euro te i njëjti park, ti e sheh ndryshimin nëse i mbjell tri lule. Edhe shkolla e Sllatinës ka ndryshua faza e parë u krye, e fazën e dytë e ke pas ti, po a e ke pagua e që ke be dallavere, na e dimë krejt i ke nëpër gjykata tash. Kanalizimi i Smirës, fazën e parë e kam pas krye, e fazën e dytë ke pas me krye, a e di a u kanë qai projekt, a janë krye dy gropa skeptike 50.000 euro i ha, a janë krye ku janë, ti e ke pranua qeta shko këqyre ku është.

Nënkryetari Hasan Aliu: Unë kam mendua që po bisedojmë për Kabin e Kornizën Afatmesme Buxhetore, po bisedojmë a e kanë qëllu këto burra të cilët e kanë bërë një shpërndarje prej atyre 700 e kusur mi euro në ato punëtor. Tash edhe ne fillim duhet te ruhem i prej këtyre seneve, është herët me u qua ne fushatë, ke me pas punë sa dush, evidentoj krejt qa ka t ‘meta të kësaj Qeveria brenda katër viteve thuaj ka me të ardhë koha, por jo sot, se sot kemi diçka tjetër, ti duhet me ju përmbajt rendit ditës dhe te gjithë, ne do te dalim me ato që i kem krye, i vje koha, ti ke me dal për ato qe si ke krye, qe ke pas obligim mi krye, normale janë këto sene, po jo sot, hime në temë e bisedo për rendin e ditës, e ke me pas edhe raportin e kryetarit a e di ti, sot ti po bisedon për Moraven që e paske pas ndreq goxha herët, që se ke pas ndreq ti e kanë pas ndreq edhe ma herët, nuk dua me hi në ato detale, i di krejt se jam pjesë e Pushtetit Lokal herë pozitivë e herë opozitivë, po zhvillimet në Viti nuk duhet ti përmendmi sot, nëse ke propozime konkrete urdhëro debatojna, se nuk na ka hije katër muaj përpara mu leshu në këto qëshetje, i vjen koha hiq so problem. Shyqyr që

kena hi në sistemin pluralist na kemi dhanë viktima për me ardhë në këtë gjendje, kem aradhë me rrezua sistemin monist me qenë shumë parti me dal me ide, por jo mu shfrytëzua këtu se hala funksionaliteti i Kuvendit duhet të ruhet se keni obligime që ka me ardhë edhe buxheti i vitit 2018 pavarësisht kush do të jete, qe kjo strukture e kjo përbërje keni me debatua lidhur me këtë dhe me aprovua. Ju kisha këshillua te gjithëve që të kursehemi në këtë drejtim, nëse ke propozime konkrete lidhur me këtë po, faleminderit shumë.

Daut Xhemajli: Faleminderit nënkryetar kemi hy me një debat që është mirë me u be, po se ka rendin sot ose në këtë pikë edhe pse ma herët u tha se na si Viti, ose po them unë po vazhdojmë të jemi të diskriminuar, po vazhdojmë mos me ditë me votua, s'kemi ditë hiq në këto zgjedhje, kemi favorizua Komunat tjera e aspak s'jemi tregu lokalist qysh kemi deklarua nganjëherë. Vitia është e papërfaqësime në kuptimin korrekt, pavarësisht se përfaqësuesi e një subjekt e zgjedhe ose dy subjekte, se edhe Nisma e ka një deputet nga kjo Komunë me prejardhje nga Verbani Bilalli p.sh. Por nuk ka rendësi ata janë përfaqësues politik partiak. Po dua me besua edhe me temën që kemi pas një qeverisje ndryshe ma të drejtë ne raport me Komunat edhe me qytetaret, e dini sahere kemi fol për trajtimin e pabarabartë te Komunave apo trajtimin sipas qafave të Ministrave, e zyrtarëve tjerë. Po besoj që Kosova e ka rendin me pas një qeverisje ndryshe, ka me fillua luftën kundër kimit edhe kundër korrupsionit që po na brengosin gjithëve. Një qeverisja po besoj që ka me funksionalizu ndryshe qeverisjen ne Kosovë, se nuk jemi të kënaqur. Lidhet me Kabin se besoj që nuk ka me pas keqpërdorim te buxhetit, të shërbimeve madhrave me kontrata në vepër, me punësime politike, besoj qe ka me fillua funksionalizmi i administratave komunale ose qendrore edhe eliminimi i vendeve të punës fiktive që na si Komune jemi të ballafaqua me të, se e kemi si buxhet qe e paguajmë për paga dhe mëditje për punëtor që as nuk e dine qa bajn, as nuk kane përshkrime te vendeve te punës, besoj qe o breng jo vetëm e jona po e krejt nivelit te vendit Kosovës. Unë te një pjese e Kabit insistoj dhe sugjeroj te projektet kapitale te kemi qasje ndryshe, jo fontane dëshirave dhe projekte qe me një forme dojm meja be qefin ose luftë për vota, i shtim si projekte shkel e shko, ose si realizojmë mirë, ose si realizojmë fare. Unë kërkoj që asnjë projekt kapital mos të futet në buxhet pa analiza profesionale, pa projekt kryesor dhe detal, sepse ai projekt duhet mu kane publik, sepse krejt procedurat, defektet fillojnë aty, e po përfundojnë me realizim të projekteve të këqija, me mos mundësi mu mbikëqyrë ato projekte, krejt përgjegjësia jonë është për nja 3 milion në këtë rast, 2 milion e diçka për projekte kapitale edhe nja për shërbime të madhrave, që kemi përgjegjësi si Komunë me administrua këta tre milion. Mendoj se te projektet kapitale duhet të parashihet me prioritet të veçante rivitalizimi a po funksionalizimi i ujësjellësve dhe kanalizimeve nepër gjitha fshatrat tona. Ju e dini sa kanalizimi, sa ujësjellësi janë jo funksional, sa milionat kane shkua atje e ata nuk janë funksional, në këtë aspekt edhe punët që janë tu be në fshatra tjera, s'po them këto të fundit Verban e Smirë gypa keni shti, po ujë me pi prej tyre këta njerëz zorë e kanë me këtë qasje, me këtë farë dinamike, pa mbikëqyrje, herë gjuhet faji te Komuna, herë te Ministria, te donatoret, problemi është që ato mjete ti parashohim, ti destinoj saktë, që të kem projekte detale, që realizimi i tyre mos të bahet temë e debatit mbas andej, n ashta edhe jo profesional është bë keq trotuari, mundesh me hecë ose s'mundesh me hecë me një trotuar. Ju drejtor, kryetari, ekzekutivi duhet të kujdeset për projekte të mira me shti në këtë listë, e kjo listë me u realizua, e jo me qenë fontane e dëshirave. Ky buxhet nuk është i kësaj Qeverisje, është i Qeverisjes së ardhshme, nëse mendon dikush me marr qeverisjen duhet me kontribuar konkret, e me mëndu saktë qa ka me u realizua edhe qysh ka mu realizua, pa ekipe këta sun e banë, po ta keni parasysh.

Ali Bajrami: Përshëndetje për të gjithë, dokumentin Kornizën Afatmesme Buxhetore që e kemi sot para veti, është dokument strategjik që mundëson funksionimin normal të Komunës për vitin kalendarik njëvjeçar. Këtu e kemi para vetes rritjen e bruto produktit vjetor në shkallë prej 4.1% që gëzon fakti se me rritjen e bruto produktit vjetor rritet edhe mirëqenia e qytetarëve. Puna që u bë në nivel qendror, nëse hymë te diagrami faqe 10 dhe e shohim është fakt që 2014-ten ka qenë buxheti ma i avancuam në krahasim me vitin 2016-të, këto kanë qene strategjia e nivelit qendror dhe nuk është kontribut individual. Për vitin 2017 kemi rritje të buxhetit për 7.17%, është mirë që e kemi këtë rritje edhe në rritjen që e kemi për projekte, për investime kapitale në vlerë diku mbi 700.000 euro se 1 milion e 500 e diçka mi euro, 1 milion e 700.000 e 1 milion e 200.000 mi euro, qëllimi është që këto mjete të investohen dhe të orientohen aty ku ka nevojë qytetari i Komunës së Vitisë. Përprojekje duhet të bahet që të kemi rritje te grandet e subvencioneve për bujqësi, edhe Drejtorinë Kulturë Rini dhe Sport, Vitia është si Komunë bujqësore që merret ma tepër. Edhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport meriton të investohet, se çdo gjë që investohet në rini na kthehet në mënyrë shumë të suksesshme. Te paraqitja Skema e buxhetit është ajo që mbi 89% i kemi grande edhe shërbime e madhra, të hyrat vetanake kanë një ramje, si Drejtori e Financave të bahet përprojekje maksimale që shuma e parapamë të rritet që qytetarëve t'ia kthejmë në investime për mirëqenien e tyre. Drejtoria e Shëndetësisë duhet të bëjë përprojekje që me siguria një okulist se ka nevojë Komuna e Vitisë.

Baki Nebiu: Nuk dua të përsërisë ato që u thanë, pajtohem me disa fjale që i kërkoj asambleistja Mirlinda, sidomos në përfshirjen sa ma të madhe të bursave në këtë strategji, strategjitë duhet të jenë të përfshimë në këtë propozim. Po dua mu ndal vetëm te Klubi i Pozheranit, mendoj qe ne kontributin tonë duhet ta japim me ligj, duhet ndarë, specifikohet super ligja, liga e pare, liga e dytë në Kosovë, duhet ndarë një fond prej kësaj Qeveria, nuk ka nevojë "Vllaznia" e Pozheranit për lëmosh prej neve një mëditje si tha kryesuesi ma herët, unë nuk mendoj kështu edhe pse nuk jam kundër, ata e bëjmë kur të doni, po Klubi ka nevojë për një ligj që i takon çdo vjet mbështetjen e Qeverisë Komunës Vitisë sa me shumë që të qëndroj në superligë, të jetë e specifikume në gjitha ligat. Është mirë me shti në propozim se është meritë edhe për neve arritja e Klubit.

Bislim Bislimaj: Ne që po dalim para foltores, kemi përgjegjësi prej atyre që na paguajnë neve këtu ti cekim këto probleme dhe të merremi me zgjidhjen e atyre problemeve. Ne mesin tonë kemi lloj lloj profesionesh, mjek, arsimtar e profesione tjera, e asnjëherë nuk kam vërejt dikush përveç te arsimiti, po në fushat tjera profesionistet që janë këtu mase pakti kanë bë kritika, pamarre parasysh se a jemi pozitivë a po opozitë, për këtë arsye jemi këtu ku jemi, vet jemi te pru këtë situatë edhe jemi te zhegitë pa pas mundësi me ndryshua. Indikatorit ma i mirë qa jemi tu be na është populli, na ka dënua, unë s'po them që kam fitua, na ka dënua në atë kuptimin moral asnjëherë nuk i kam ni këta këtu që janë prezent me fol për problemet elementare të Shëndetësisë, për mi hjek disa arritje dhe përparësi p.sh. Rregullimin e ambienteve, por në esencë se a kemi mjete, a kemi ilaçe, që katër vjet që jeni këtu pe merrni paren e popullit,

tregoni se në qfarë gjendje është p.sh., rëntgeni, stomatologjia, intenestika, gjinekologjia, e mos të merremi na me rregullimin e rrugëve. E vetmja shpresë e atyre njerëzve që donë me përfitua diçka është investimi në Bujqësi, kotë na mbajmë parqe, që than parku ka qenë i pa rregullum në kohën e PDK-së, e tash u rregullua, po në kohën e PDK-së ka vlua parku prej njerëzve se ka pas rini, e sot është me lule po nuk ka rini, se e kanë humb shpresën e janë largu edhe fëmijët e mi edhe t’ju v kanë me ik, nuk rrinë kurrkush këtu, se na nuk mendojmë ashtu qysh duhet. 33.000 euro për Bujqësi është hajgerë me be me neve. Aty ku është bujqësia që mundet mu zhvillu diçka, na më së paku punojmë, te Ministria Kultura Rinia Sporti është punuar diçka, mirëpo ka mundësi mu punuar ma tepër. Kemi investuar në këtë sallë po nuk ka teatër, teatri është pjesë e jona se në kemi të drejt me vota me themelua, pse se bajm këtë punë që katër vjet.

Vehbi Rama: E kuptoj shqetësimin e kolegut, është një thajne popullore, me kalimin e viteve njeri po afrohet nga shëndetësia, ka nevojë n ashta për neve Policia, burgu po shëndetësia, po propozoj që aparati në Shtëpinë e Shëndetit letë rregullohet edhe barnat mos të vjedhin, kjo u dëshmuar para një muaji që punëtori u arrestua. Ambulanta në fshatin Zhiti është e rregullume, aty fatkeqësisht mungojnë punëtorët mund të hapët.

Z nj. Vjollca Kadolli-Hlili: Me thanë që ski ndryshime në Shëndetësi me duket si mos me kanë banor të Vitisë, Bislim t ‘kam pa shumë herë në Ambulantë, fatmirësisht e ke djalin mundesh me pyet për barnat esenciale ka vinë ato barna, kurrë ma mirë nuk ka qenë Ambulantë e Vitisë me barna esenciale sa përpara, është e vërtetë që kemi mungesa, po ato varën prej Ministrisë. Komuna e Vitisë ka qenë nderë Komunat e vetme që kemi bërë zgjidhje tjetër për mos mi lanë banoret pa insulinë. Tash po bindem që e keni pashkak të zgjedhjeve. Thatë Stomatologjia nuk është tu punua kanë qenë tri karrige që dy s’kanë punua fare, e sot i kemi marr dy treja që i kemi marr në vlerën diku 15.000 euro e janë fenomenal, e kemi shtua edhe stafin shëndetësor përmes Karitasit, ndryshe punojnë katër karrige të rregullta, dy janë të reja te 2016-tes. Kemi internist prej vitit 2016, i kemi ekagea të reja, nja e mbajmë për terren që shkojmë mi verifikua edhe vdekjet në terren. E në gjinekologji lindje ski pas po është numri mbi 1,000 minimumi që marrin gratë shërbime aty, e për lindje gratë nuk ndalen vet.

Taib Alidema: Çka do që flasim është rreth Kornizës Buxhetore kryesues, unë kam pas një përvojë gjashtë vjeçare drejtor në Shëndetësi. Kam pas bo kusht vetes që unë si këshilltar Komunal kurrë nuk do ta pengoj pozitën në qatë formën qysh përherë ka kërkua nenkryetari Ambulanta në Remnik, e tash as nënkryetari i Komunës nuk arriti me aktivizua Remnikun. Shëndetësia ka probleme shumë të mëdha, unë në fillim kam thanë që nuk keni qasje të mirë, as qeveria e mëhershme nuk ka pas, e keni mendua që unë po bojë politikë. Kam pas rast në kuvend që kam propozua që Stacionin e Autobusëve ta japim me koncesion që ndërtohet një godinë e madhe aty e biznesit, që mundësisht nja 10 mjekëve ti japim banesa që ti lidhmi për Viti, mjeket e mirë nuk të rrinë në Viti. Është gjendje alarmante sa i përket furnizimit me barna ka qenë politikë e gabuar e Ministrin të Shëndetësisë kur vet e kam dëgjua tu thanë që nuk po qojmë në Ambulante shurupe se pi vjedhin, po pi japim injeksione, ajo është komplet në kundërshtim me programin e mjekësisë familjare. Sa i përket Arsimit jam edhe ma i zhgënjyem se shihet në bazë të rezultateve të studentëve nëpër fakultete ku ka konkurrencë që tri katër vite nuk kemi regjistrime. Sa i përket Kornizës Buxhetore qa të them kur ti ski tregu se cilën rrugë kem me shtrua, cilin kanalizim ke me

bë, a po qa keni me bë, komplet buxheti i fundit kur kemi qenë atje në debat në Pejë për diskutim, na nuk dyshim qa me diskutua se nuk di shmi ku mu kap, se s'keni tregua se ku ka mu bë investim, kjo është alarmante për këtë Qeveri, duhet meja vu emrin qa ki me bë. Unë besoj që nuk do të jetë ky buxhet zgjedhor, besoj që do ta kjarhtësoni deri në Shtator kur të vje për miratim.

Nënkryetari Hasan Aliu: Mirë që e paske mbajt evidencën, shumë aktiv kam qenë edhe si opozitë, jam edhe si pozitë, unë e kam thanë edhe e them edhe sot se ajo Ambulantë meriton me qenë e hapur, e ju them çdo ditë edhe mjekëve. I nderuar mjek gjithë herë ta kam ç' mu ti e dinë profesionalizmin tan për kontrolle e për krejt, por kurrë nuk ta çmoj mos 'shkuarjen tanë në punë, se je obligativ për me shkua, duhet me mbajt orarin e punës, me kontribuu. Ajo qa kam thanë mos të djeg se u kanë për të mirë, unë do të insistoj edhe për vende tjera.

Taib Alidema: Na jemi aq të njohshëm mes vetë thua se jemi familjarizim, jemi Komunë e vogël, e unë jam i pirur që mi respektua koleget, kryetarin e gjithë. Mua patjetër mu ka dashtë në çdo foltore me dal, e kam pas presionin prej kryesisë temë, qysh po të del ty nënkryetari e drejtoresha në çdo seancë e ti s'po del me kundërshtua. Unë jam për me ndihmua, ju kam dhanë këshilla për përvojën që e kam, unë e jap kontributin temë. Në kohën kur e kam krye një specializim ju më keni qitë prej punës, kam shkua me marr pagën aty 13 herë kam hi kanë thanë ski pagë, nuk e stimuloni ju kuadrin e juve. Unë ju tregova që doktori i Vitisë duhet me shkua nëpër vatra të luftës për me ecë përpara se nuk i jepet mundësia. Nuk është gjithçka bardhë por nuk është edhe zi, po duhet me pas bashkëpunim edhe ma të sinqertë, nuk është e mjaftueshme Vitisë mi vetë mjaftua kuadrat e LDK-së mos me lyp ndihmë të VV, e të PDK-së.

Sejdi Emini: Ma së pari kisha kërkua prej Taibit që mos me përmend qeto që mi maru doktorëve banesë në Viti, s'mu doket e ndershme, kemi probleme tjera, halle, njerëzit me skamje, pa kulm mbi kokë, kemi gjana elementare, e ti se je mjek me specializim me kërkua banesë me bo me ta dhanë pe marshe, nuk është e ndershme e ke rrogën 1,000 euro e po lyp banesë. U diskutua rreth barnave, nuk është që ski barna, po pi vjedhin, e duhet mu sqarua këto sene.

Kryesuesi z.Naim Pira: U parashtruan disa pyetje për Kabin e kisha lutë drejtorin që mundësisht të na jep përgjigjeje, se kaluam prej temë e caktojme një temë si pikë e rendit të ditës, e diskutojmë e jo mi përzi temat.

Ibrahim Rama: Unë do të përgjigjem në ato pyetje që i parashtruat. Buxheti i vogël ose i madh, e kemi diskutua edhe unë kam qejf buxheti mu kanë edhe 10 herë ma i madh, shpërndarjen e buxhetit e bënë ligji në fuqi, Ministria e Financave i përcakton kornizat për secilën kategori ekonomike, tu fillua prej pagave, shërbimit të madhrave, sun del jashtë atyre kornizave asnjë këshilltar e as kryetari i Komunës. Shpërndarja e investimeve është një proces nashta jo i drejt se mi vet qytetaret sa janë me regjistrim 47.000 duhet mi pas 47.000 projekte secilit mi thanë e kena marr ka një e me qene korrent me kohen edhe me kërkesat e qytetarëve, shpërndarja duhet me qenë drejtë. Unë kam than disa herë e them edhe tash Qeveritë, buxheti, njerëzit, profesionistet mbahen mendë jo me buxhetin e madh sa e kanë pas, po me prioritetet që ja kanë caktua drejt me investua në atë buxhet, buxheti e merr formën e prerë ligjore atëherë kur miratohet, e nuk besoj qe duhet me pas vërejtje në atë buxhet që u miratua. Të hyrat vetanake është një përvojë që na nuk e kena shpik, është ligji në fuqi, e të gjithë këtë projeksion të hyrave vetanake e kena bë në bashkëpunim me drejtoret e drejtorive përkatëse. Në funde del që mirë i kena realizua edhe pse jo në vendet

sipas pozicionëve të caktume po si total i të hyrave vetanake e për këtë kena marr mirënjohje edhe nga ju edhe nga qytetarët e 17 vite janë kanë ma të mëdha ja të hyrat vetanake të vitit 2016 qe janë inkasua. E numri i punëtorëve në administratë të përgjithshme edhe në shëndetësi është i saktë, devijimit prej numrit 796 mu dukë keq, se 815 është qasje e punëtorëve të arsimit edhe asnjëherë numri i lejum nuk guxon mu barazua me numrin që është i punësuar e që janë në listë të pagave, për arsye të problemit të lehonisë, ku gjithërë duhet me pas rezervë të punëtorëve për mi plotësua deficitin e pagave, ky është ai ndryshimi 796-815 nuk është gabim profesional, është gabim shumë i saktë, mundësia e numrit të lejum është 815. Komuna e Vitisë e ka zanë vendin e parë në Kosovë për buxhet, për shfrytëzimin e buxhetit, e asnjë shkelje materiale nuk është konstatua deri m sot në keqpërdorimin e buxhetit, as në drejtorinë e as në nivel të Komunës. Ne jemi të pajtimit që buxheti duhet me qenë ma i madh, por ajo qa kishte me qenë në konkludim për mua sot, ju me më ndihmua, konkretisht me thanë që kjo s'bënë, e kjo duhet sipas meje, se gjithmonë ajo personalja është relative, e në këtë kuptim na ndihmon me mbledhë na informacionet me bë një draft deri në Shtator të mirë. Buxhetet deformohen gjatë ekzekutimit, e jo në përpilim, gjatë ekzekutimit buxhetet pësojnë ato defektet e problemet që unë kisha qenë së bashku me juve mi eliminua në të ardhmen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju falënderoj të gjithëve rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe me që jemi 20 prezent sot në Kuvendin Komunal dhe të tjerët nuk janë këtu, është një sugjerim edhe për mua e të tjerët që të bahet do lista të nënshkrimit dhe ta shohim cilët janë ata që rrinë deri në fund dhe do ta aplikojnë këta, e kisha qitë në votim kush është që të miratohet me ngritje dore.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë e qes në votim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatoj se me 5 (pesë) abstenime dhe të tjerët pro miratohet kjo pikë e rendi të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e dhënies ne shfrytëzim afatshkurtër pronën e paluajtshme te Komunës Kompanisë Kedsit për vendosjen e trafove elektrike

Drejtoresha Fatbardha Emini: Përshëndetje për të gjithë, më lejoni të paraqes propozim vendimin për dhënien afatshkurtër pronën e paluajtshme Kompanisë Keds për vendosjen e trafove elektrike, janë propozime të zakonshme qe Komuna po i shqyrton kërkesat e banoreve për mundësimin e qasjes ma te mire me furnizim te energjisë elektrike, në parim janë dy kërkesa qe vijnë direkt nga Komuna është për te objekti i Komunës se re edhe te xhamia Këshilli i Bashkësisë Islame d.m.th.xhamia në Pozheran dhe një nga këshilli i fshatit Sadovinë e Qerkezëve, nëse keni diçka mundë të parashtroni pyetje.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth kësaj pikë.

Sejdi Emini: Mendoj që Kedsit nuk është konform kërkesave të qytetarëve të Komunës së Vitisë, ndalja e rrymës vend e pa vend, e pa njoftim, po Kedsit po paraqet edhe rreziqe për qytetarët. Kemi pas një rast tragjik para një muaji në fshatin Goshicë, ku fatkeqësisht ka humb jetën një njeri, pikërisht për mos përgjegjësisë dhe defekteve të Kedsit. Kemi shumë vende që paraqesin rreziqe, e shumë shtylla janë të papërdorura që i mbajnë telat, kemi kablllo nëpër shtylla që është tmerr edhe me i pa. Mendoj që Komuna, Kuvendi duhet me bë presion që sa ma shpejt mi eliminua problemet që paraqiten prej Kedsit. Kedsit po i këqyrë përfitimet e veta e jo të qytetarit, ju si ekzekutiv duhet me bisedua me ta e sa ma shpejt mi eliminua rreziqet që gjenden në Komunën tonë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Konstatohet se me vota të gjithëve u miratua kjo pikë e tretë e rendit të ditës

Si pikë të katërt dhe pikë të pestë po e quaj kështu e rendit të ditës kemi:

4-5. Propozim vendim për shfrytëzimin e miratimit për zonën në interes të përgjithshëm parcelat kadastrale në Radivojc, kemi të bëjmë me disa rrugë të lagjeve që i menaxhon AKP-ja dhe ne si Kuvend Komunal kem për obligim të marrim një vendim që ato rrugë të shpallen si pronë e Komunes, që të lejohet investimi i mëtutjeshëm dhe të njëjtën kohë e kemi edhe në Drobesh.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat rreth kësaj pikë.

Drejtoresha Fatbardha Emiri: I kemi dy propozim vendime të cilat vijnë në sajë të kërkesave të këshillit të fshatit Radivojc dhe këshillit të fshatit Drobesh dhe fshatit Smirë. Ju e dini që shumica e pronave ende menaxhohet nga AKP-ja edhe pse jemi në qasje të bisedimeve dhe përkthimin e atyre pronave, por ende zyrtarisht nuk kemi, e për këto dy propozim vendime kemi të bëjmë me rrugë të lokalitetëve të cilat për vite të tanë janë rrugë të shfrytëzueshme nga banoret e atyre lokaliteteve, po në parim janë rrugë që menaxhohen nga AKP-ja, për shkak se janë në pronësi të ndërmarrjes Agromorava, unë kam bisedua me stafin e AKP-së e ata kanë sugjerua të ndjekim këta procedurë d.m.th. të shpallen me interes nga Kuvendi Komunal, e pastaj të shfrytëzohen procedurat tjera për kthim të Komunes së Vitisë.

Selvije Rexhepi: Përsëritet për të gjithë, po ja kthej përgjigjen Drejtorit për Financa për krejt punën që e kanë, ju e dini se disa pyetje që i kam bërë unë po shkon mandati e s'ma keni kthyer përgjigjen, jam shumë e sigurt që buxheti i Komunes 65% shkon paga, 20% kapitale nuk e kishte përgatitë listën që të kemi mundësi me ju dhanë vërejtje. Këtu thotë propozim vendimi duke u bazuar në kërkesën e këshillit të fshatit Smirë, duhet të jete p.sh. në Radivojc d.m.th. po shihet edhe këtu papërgjegjshmëria që me vje keq prej drejtoreshës po më nxitë që të flas, ka qenë mirë që të përmirësohet kjo. E mos përmendni me emra se unë dashta ta kursej edhe Kornizën Buxhetore. Nuk bëjë fushatë para kamerës për veten teme.

Kryesuesi z.Naim Pira: Konstatohet se dy pikat e rendit të ditës u miratuan

Si pikë të fundit në rendin e ditës e kemi:

Raportin e punës për KKSB-së, ju e keni pas të gjithë materialin, nëse doni ja jap fjalën nënkryetarit, po nëse nuk e shihni të arsyeshme besoj që e keni lexua.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka për diskutim, ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë.

Shpallë të mbyllur këtë seancë, shihemi në seancat e ardhshme.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:50 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
